POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1

Jeta e Roberto Baggio-s në fshat, 'Bishtaleci Hyjnor' jeton në shtëpinë e rrethuar nga gjelbërimi dhe rrit kafshët

2

Kush është i burgosuri në burgun e sigurisë së lartë që çoi policinë në 'kështjellën' e Ervis Martinajt

3

VIDEO tronditëse, Pele i jep lamtumirën familjarëve dhe miqve nga telefoni

4

Urdhër për vrasjen e 2 shqiptarëve në Athinë dhe Edmond Papës? Kush është Klodian Lekocaj, mesazhi nga burgu: Unë kreu i mafias? S'kam lekë as për 1 paketë

5

Makina e tij e parkuar ngjalli shumë dyshime, policia italiane arreston 25 vjeçarin shqiptar që shiste kokainë, i gjenden 80 doza dhe mijëra euro 'cash'

Kronikë

Rrethohet për 5 orë 'kështjella' e Ervis Martinajt, gjenden 2 automatikë, 7 mijë fishekë, 85 predha, 9 uniforma policie, maska gome, i kishin fshehur në kosheret e bletëve (VIDEO)

Pesë muaj pas zhdukjes, FNSH dhe RENEA kanë zhvilluar sot për herë të parë kontrolle në shtëpinë e bosit të lojërave të fatit, Ervis Martinaj. Kontrollet nisën orët e para të mëngjesit të sotëm dhe zgjatën për rreth 5 orë në të gjithë zonën e Fushë Kuqes në Kurbin, aty ku ndodhet edhe banesa e Martinaj.

- Kush është i burgosuri në burgun e sigurisë së lartë që çoi policinë në 'kështjellën' e Ervis Martinajt
- Kontrolle në shtëpinë e Ervis Martinajt, policia mori indicie nga një telefonatë nga burgu
- VIDEO/ Me portë të blinduar, e rrethuar me mur 3 metra tre metra të lartë me tela me gjemba e me kamera sigurie, detajet nga 'kështjella' e Ervis Martinaj
- Kontrollet në Fushë-Kuqe për Ervis Martinajn, FNSH 'zbarkon' edhe te banesat e familjarëve

Lajmi i fundit

VIDEO/ Liverpool fiton në transfertë, Arsenal bën detyrën dhe kryeson Premier League! Newcastle kërcënon kreun, Brighton 'Hirushja' e Anglisë
26 Dhjetor, 23:03

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
26 Dhjetor, 09:17 | **Përditesimi: 26 Dhjetor, 21:09**

LEZHË- Pesë muaj pas zhdukjes, FNSH dhe RENEA kanë zhvilluar sot për herë të parë kontrolle në shtëpinë e bosit të lojërave të fatit, Ervis Martinaj. Kontrollet nisën orët e para të mëngjesit të sotëm dhe zgjatën për rreth 5 orë në të gjithë zonën e Fushë Kuqes në Kurbin, aty ku ndodhet edhe banesa e Martinaj.

RENEA dhe FNSH janë futur brenda banesës së Martinajt, e cila ndodhet rreth 200 metra larg fshatit Fushë Kuqe. Kontrolli ishte me vendim të gjykatës në funksion të hetimeve që po kryhen për zhdukjen e Ervis Martinajt, por edhe për ngjarje të tjera kriminale që kanë ndodhur në këtë zonë.


LEXO EDHE:
Dhunohet drejtori i postës shqiptare në Lezhë, 2 autorët largohen me vrap

Ajo se çfarë gjeti policia ishte një arsenal armësh, të fshehur në kosheret e bletëve. Nga sa mësohet në shtëpinë e Ervis Martinajt dhe 2 xhaxhallarëve të tij Faik dhe Rakip Martinaj u gjetën 2 armë zjarri automatike, 1 silenciator, rreth 7 mijë fishekë luftarakë të kalibrave të ndryshëm, për armë të lehta dhe të rënda, 85 predha eksplozive, 1 thikë bajonetë, 9 uniforma policie, 7 jelekë multifunksionalë, 11 kapele policie, 2 radio policie, fenelina policie, maskë gome për fytyrën dhe dokumente të ndryshme. Policia nuk ka asnjë përgjigje nëse Martinaj është gjallë apo jo, por këto kontrolle mund të jenë një shenjë se grupi hetimor nuk ende asnjë provë për vdekjen e tij. Madje edhe idea që kontrolli është zhvilluar pikërisht natën e Krishtlindjeve mund të jetë një arsye që grupi hetimor mund të ketë dyshuar se Martinaj mund të ishte për festa pranë familjarëve.

Një ndër personat më të njohur të botës së krimit, Martinaj ka një siguri tepër të lartë në banesën e tij, e cila është e rrethuar me mure 3 metra të lartë të rrethuar me tela me gjemba. Banesa e tij ndodhet rreth 200 metra larg fshatit Fushë Kuqe në Kurbin. Rruga kryesore nga qendra e fshatit deri tek banesa e Martinajt është me kamera sigurie. Ndërkohë vila ndodhet në thellësi të zonës së rrethuar me mur, rreth 500 metra nga muri rrethues.

Ervis Martinaj rezulton i zhdukur që prej 9 gushtit të këtij viti. Gjatë kësaj periudhe policia ka kryer disa kontrolle në kërkim të tij në qytete të ndryshme, operacione të cilat janë mbajtur diskrete. Drejtori i Policisë së Shtetit, Muhamet Rrumbullaku ka zgjedhur që të përgjigjet shkurt mbi hetimet pë zhdukjen e tij duke thënë se ***janë në rrugë të mbarë***.

Zhdukja pa lënë gjurmë e Martinajt ka ardhur pas dëshmisë së të penduarit të drejtësisë, Nuredin Dumani në kuadër të operacioni Plumbi i Artë, kohë kur Martinaj u shpall në kërkim nga SPAK. Dumani ka thënë se Martinaj ka qenë i gatshëm të paguante 500 mijë euro për vrasjen e Indrit Dokles. Vetë Nuredin Dumani ka thënë se ka marrë porosi nga Ervis Martinaj për ta vrarë, ka rënë dakord që Ervisi të jepte për vrasjen e Indritit shumën prej 500 000 Euro dhe se ka marrë paradhënie shumën prej 100 000 Euro. Kujtojmë se Indri Dokle ka qenë numri 2 i Bandës së Durrësit dhe është i dënuar për "Krijim i organizatës kriminale", "Vrasja me paramendim", e kryer në bashkëpunim, e mbetur në tentativë, "Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit", kryer në bashkëpunim, në kuadër të organizatës kriminale.

Nga hetimet që po kryhen për zhdukjen e Martinajt ***është lënë në burg*** një efektiv policie Jeton Lami, me akuzën e shpërdorimit të detyrës dhe dekonspirimit të operacioneve policore. Teksa po hetonte për zhdukjen e të shumëkërkuarit, policia zbuloi se për t'u arratisur, Martinaj ishte ndihmuar edhe nga ***Lami, i cili u prangos*** më 23 gusht nga policia e Lezhës.

Ervis Martinaj është një prej njerëzve më të njohur të botës së krimit në vend. Ai është konsideruar si një nga njerëzit më të rrezikshëm në Tiranë, i akuzuar për vrasje dhe i dyshuar për disa ngjarje të rënda, që kanë tronditur kryeqytetin.

Pamje nga 'kështjella' e Ervis Martinajt

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 21:05

Kush është i burgosuri në burgun e sigurisë së lartë që çoi policinë në 'kështjellën' e Ervis Martinajt



Kontrolli që Policia bëri sot në shtëpinë e Ervis Martinaj është i shoqëruar me disa pikëpyetje ku më kryesorja është, pse pikërisht tani ky operacion, kur kanë kaluar 5 muaj nga zhdukja e tij.

Fillimisht është raportuar se e gjitha ka ardhur nga një telefonatë që përgjigjet i një të burgosuri në një burg të sigurisë së lartë, që mendohet se ka ditur diçka më shumë për fatin e Ervis Martinajt. Mirëpo kush është ky i burgosur? Dyshime të forta janë se bëhet fjalë për Jeton Lamin, efektivi i policisë i cili u arrestua për akuzën e shpërdorimit të detyrës, pasi shoqëronte Martinajn pak ditë përpara se ky i fundit të zhdukej.

Mendohet se ai mund të ketë sjellë aksionin e sotëm në bazën e Ervis Martinajt në Fushë Kuqe.A ka qenë një telefonatë që përgjohej apo ka zgjedhur që të flasë para hetuesve kjo mbetet e paqartë. Ndërkohë që Prokuroria e Kurbinit ka zgjatur me 3 muaj hetimet ndaj efektivit të policisë që ishte dhe një ndër të besuarit e Martinaj.

Ora 19:07

Kontrolle në shtëpinë e Ervis Martinajt, policia mori indicie nga një telefonatë nga burgu! Çfarë u tha në atë bisedë?



Një telefonatë e bërë nga burgu, nga një i dënuar që mbahet i mbyllur në kushte sigurie të larta ka shërbyer si indicie për policinë, e cila ka nisur kontrollet në shtëpinë e Ervis Martinajt. Se çfarë është thënë në këtë telefonatë, nuk është ende e zbardhur, konkretisht, mirëpo nga sa raportohet mendohet se mund të gjendet gjurmë apo detaje që mund të ndihmojnë në zbardhjen e zhdukjes së mistershme të Martinajt.

Ora 15:39

Operacioni në Fushë Kuqe/ 7 mijë fishekë, 85 predha, 9 uniforma policie... zbulohet arsenal armësh në 'kështjellën' e Ervis Martinajt dhe 2 xhaxhallarëve të tij



Policia jep njoftim zyrtar për operacionin në Fushë Kuqe. Në shtëpinë e Ervis Martinajt dhe dy xhaxhallarëve të tij, Faik dhe Rakip Martinaj iu gjetën një arsenal armësh.

> *"Kontrolle të befasishme në 3 banesa dhe në disa ambiente, në Fushë Kuqe. Kontrollet, në kuadër të hetimeve në funksion të dy procedimeve penale "Plumbi i artë" dhe "Rrëmbim personi".*
>
> *Kontrollet, të mbështetura nga Forcat e Lëvizshme Operacionale të Policisë së Shtetit, FNSH dhe RENEA. Sekuestrohen 2 armë zjarri, 1 silenciator, mijëra municione luftarake, radio, fenelina, uniforma policie, maska dhe sende të tjera të kundërligjshme.*
>
> *Mëngjesin e sotëm, shërbimet e Policisë Gjyqësore të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe ekspertë të Institutit të Policisë Shkencore, në bashkëpunim me shërbimet e Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë, mbi bazën e vendimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në kuadër të procedimit penal të vitit 2022, regjistruar në SPAK, për vepra të rënda penale të kryera në formën e grupit të strukturuar kriminal, ushtruan kontroll në banesat e shtetasve: E. M., F. M. dhe R. M.*
>
> *Gjatë kontrollit, shërbimet e Policisë gjetën të fshehura në koshere bletësh dhe sekuestruan në cilësinë e provave materiale, sendet e mëposhtme:*
>
> *• 2 armë zjarri automatike, 1 silenciator, rreth 7 mijë fishekë luftarakë të kalibrave të ndryshëm, për armë të lehta dhe të rënda, 85 predha eksplozive, 1 thikë bajonetë, 9 uniforma policie, 7 jelekë multifunksionalë, 11 kapele policie, 2 radio policie, fenelina policie, maskë gome për fytyrën dhe dokumente të ndryshme.*
>
> *Gjatë kontrollit nuk janë gjetur vlera monetare.*
>
> *Provat materiale do të dërgohen në Institutin e Policisë Shkencore, për ekzaminime të mëtejshme laboratorike", thuhet në njoftim.*

Ora 13:52

VIDEO/ Me portë të blinduar, e rrethuar me mur 3 metra me tela të lartë e me kamera sigurie, detajet nga 'kështjella' e Ervis Martinaj

Kjo është porta e vilës së Ervis Martinajt. Banesa e tij ndodhet rreth 200 metra larg fshatit Fushë Kuqe në Kurbin. Muri rrethues i vilës është rreth 3 metra i lartë dhe i rrethuar me tela me gjemba. Po ashtu edhe rruga kryesore nga qendra e fshatit deri tek banesa e Martinajt është e ndriçuar me kamera sigurie. Ndërkohë vila ndodhet në thellësi të zonës së rrethuar me mur, rreth 500 metra nga muri rrethues.

Ora 11:30

Përfundon kontrolli në shtëpinë e Ervis Martinaj, RENEA largohet nga Kurbini pas 5 orësh (VIDEO)

Ka përfunduar kontrolli i FNSH dhe RENEA-s në shtëpinë e bosit të lojërave të fatit, Ervis Martinaj. Pas pesë orësh, FNSH dhe RENEA janë larguar nga zona e Fushë Kuqes në Kurbin, aty ku ndodhet edhe banesa e 40-vjeçarit. Ende nuk dihet nëse është gjetur ndonjë send me vlerë që mund t'i shërbeje hetimeve për zhdukjen e tij.

Ora 10:33

Kontrollet në Fushë-Kuqe për Ervis Martinajn, FNSH 'zbarkon' edhe te banesat e familjarëve



Për gjetjen e Ervis Martinajt, FNSH po kryen kontrolle edhe tek banesat e familjarëve të tij. Burime nga Prokuroria e Kurbinit për gazetaren e Report Tv, Keti Banushi, bëjnë me dije se kontrollet në Fushë Kuqe janë me vendim gjykate në kuadër të hetimeve për ngjarjet që kanë ndodhur në këtë zonë, përfshirë edhe zhdukjen e Ervis Martinajt që prej datës 8 gusht 2022.

Përveç kontrolleve në shtëpinë e Ervis Martinajt, objekt i kontrolleve të forcave të policisë janë edhe banesa dhe ambiente të tjera, përfshirë të njohur dhe familjarë të tij, përmes së cilave synohet të sigurohen prova për t'i dhënë një përgjigje fatit të Martinajt.

Dosja vijon të hetohet nga Prokuroria e Kurbinit, teksa të njëjtat burime bëjnë me dije se nuk pritet t'i kaloj SPAK për hetim, të paktën për momentin. Kontrollet e FNSH kanë nisur që prej orëve të para të mëngjesit.

Ora 10:32

FOTO/ E rrethuar me mure të larta, tela me gjemba dhe kamera sigurie, si e ruan Ervis Martinaj banesën e tij në Fushë Kuqe

FNSH dhe RENA kanë zhvilluar ditën e sotme kontrolle në banesën e Ervis Martinaj në Fushë Kuqe. Në foton që sjell Report Tv vihet re siguria e lartë në shtëpinë e bosit të lojërave të fatit, Ervis Martinaj

Siç shihet në foto, banesa e Martinajt i ngjan më shumë një fortese të sigurisë së lartë. Shtëpia rrethohet nga një mur i lartë i rrethuar me tela me gjemba, si edhe është e pajisur me kamera sigurie.

Duket se Martinaj, një personazh i njohur i botës së krimit, i ruhej një hakmarrje të mundshme.

Ora 10:03

VIDEO/ Kontrollet në shtëpinë e Ervis Martinaj, RENEA 'blindon' Fushë Kuqen

FNSH ka zbarkuar në orët e para të mëngjesit të sotëm në Kurbin, ku ka zhvilluar edhe kontrolle në shtëpinë e bosit të lojërave të fatit, Ervis Martinaj. Report Tv sjell video të FNSH në Fushë Kuqe.

SI.E./B.K./Shqiptarja.com

TAG: jeton lami Lezhe Ervis Martinaj Kurbin fnsh Renea

Komento

Komente

Vlor: 26/12/2022 21:04

Eshte poshtersi te trajtohet familia Martinaj ne kete menyr Jan fis pateriotik ku fisi Martinaj ne plav e Guci kan dhen contribut te jashtezakonshem Kundra serbo malazezet.

Përgjigju

Emiljano: 26/12/2022 19:45

Si rruhet shum tr**i rames per SHOW . As per me gjet visin qe e kan vra vet . Kjo esht per te demtuar xhajat qe bejn gam gam neper televizione, Sikur me qen berisha. Po ne te vertet edhe potencialin e kan me marr hak nqs Kan leket. Por me kte mesazh sot edhe nqs nuk futet njeri ne burg sdo ken me siguri te rrin te armatosur lirshem gje qe Do e bej dhe hasmin me te lodhur ti versulet nqs kan mendje te keqe.

Përgjigju

Arkitekti: 26/12/2022 19:29

Eshte histori e degjuar kjo, historia e fatmir haklajt. Shteti i lidhur me segmente te krimit kerkon te te shfarose. U be kjo histori sikur vetem familjaret e martinajt jane te rrezikshem ne kete vend. I godasin bandat i godet dhe shteti. Turp per policine qe behet vegel e bandave. Na e bete telenovele prap kete histori

Përgjigju

Maksi: 26/12/2022 19:25

Interesante. "Bosi" i bixhozit me arme te 97es, fisheke qe nuk bejne dhe arme te ndryshkura. Nga "kontrolli" ne banese, thote policia, gjeti ne fushe me bar ...arsenalin! Jane dicka ky karteli i policise se ish MPB enveriste. Ashtu si atehere, me pese genjeshtra mashtrojne dynjane. Meqe bosin e qeruan, le te marrin fryme lirisht ortaket bixhozxhinj te Rames, qe jo kot vetem droge, bixhoz dhe pastrim parash bejne, si qirje Luca, Doshi apo Sulaj i tajvanit...

Përgjigju

Arkitekti: 26/12/2022 18:01

Show i policise per miletin dhe nga ana tjeter levizje tu beje presion dy pleqve qe kane mbetur atje. Te gjithe e dine qe ate e kane ekzekutuar, ne vend qe tu sulen vrasesve qe policia i di shume mire, u cojne renean pleqve te shtepia per tu bere presion te rrine urte. 15 shoke te vrare, martinajn po te vrare, e shteti u sulet familjareve te martinajt. Duket cfare synimi ka shteti.

Përgjigju

hajdute: 26/12/2022 17:30

Arme paska gjetur po euro jo? Kush e beson kete? Dikush ka folur

Përgjigju

aleksadros: 26/12/2022 16:33

Bravo policia respekte

Përgjigju

Alb: 26/12/2022 16:27

Po arrestime për gjithë këto municione të gjetura?

Përgjigju

Visi: 26/12/2022 16:21

Ai ka kry pune po kjo eshte se folen Thane na e ka gjakun borxh km.. Vete e krujten Tashi te gjithe burg dhe sngelet kush me Vetem po u cu luani me fol e me bo atentat

Përgjigju

Artioni: 26/12/2022 16:18

PO XHAJA I KETIJ SIKUR DOLI NA MBAJTI FJALIM PER CFAR I DUAN GJITH KETE ARSENAL ARMESH APO E DIN QE JAN KRIMINELA TRIMAT E XHA JAHOS SI JINI VET BET DHE FEMIJET FUNDERRINA.

Përgjigju

Beni: 26/12/2022 15:59

Te kerkosh te vdekurit per te gjalle kjo eshte nje hipokrizi e madhe e policise !

Përgjigju

> **Ademi:** 26/12/2022 16:27
>
> Po ti ku e di se eshte i vdekur „,? Qe je kaq kopetent apo te flet truri para gojes...

jaane betua: 26/12/2022 15:50

Kjo ashte me i rrase ne burg baben e axhat se Visi ka krye pune. Miqte e shpise, Kacorret jane mundua te vjelin borxhet qe ka Visi neper njerez dhe per te gjetur nje ushtri me marre gjaqet.

Përgjigju

Anonim: 26/12/2022 15:22

Derisa ky trimi qe esht zhdukur e po e kerkojn esht gjall se ne patog ku ka bler token te sulen trimat e tij akoma dhe te maresh nje dru vin makina me vrap, ose loj e prokuroris se kurbinit pasi ky trimi i ka bler me koh e me vakt dhe komisarjatin e policis , mir esht te jet gjall qe ta di cfar esht burgu se vdekja e ketyre kriminelave esht kapak me mjalt, te gjith si lepuri ne vresht do shkojn .

Përgjigju

ÇARRANIKU: 26/12/2022 14:28

O more njeri fjalt e te vjeterve me qindra vjet kan ken te provume e STERPROVUME nga jeta e perditshme e njerzimit me shekuj si PO VRAVE KAN ME TE VRA,AI QE TE PRET TE VRET dhe HAK PA MARRE E HAK PA LA NUK KA MET NE KET DUNJA edhe GJAKU LAHET ME GJAK.

Përgjigju

Bardhanjori: 26/12/2022 14:09

I keni ne Shkoder tek Lict dhe isufte i njejti rrethim pse?

Përgjigju

> **O jari:** 26/12/2022 14:13
>
> Qa flet mor nish

Shkodra: 26/12/2022 14:04

Ky operacion tregon se esht gjall

Përgjigju

> **Edi Rama Mafia:** 26/12/2022 14:57
>
> show prej qeverise me humb vemendjen se Edi Rama me mafian e vet e din mire se ku asht e si ka shkua ne boten tjeter

Drejtoria e Pastrimit: 26/12/2022 13:55

Po mire mo keta te Pastrimit te Parave a OFL do kujtohen cik mer jahu per me i sekuestru pronat ktyne apo vari lesht merren me qytetaret e ndershem me na ca drrasat ne bank kur te kane ardh 300 euro nga amerika ku i more si i more lale! Ktyne tipave qe levizin me makina 300 mij euro me vila me gjona kur do ja sekuestroni? Se dihet qe ai cer ka qene ka pastru leket e te tjereve.

Përgjigju

> **Dalip:** 26/12/2022 17:49
>
> bravo drejtoria pastrimit

Ilia: 26/12/2022 13:52

Ky ndodhet te ben kacorri ne barcelon

Përgjigju

> **O visi:** 26/12/2022 16:00
>
> ????????????

> **O Iliaaaa:** 26/12/2022 15:28
>
> Kujt ja ka rras Visi te shpija ….. e jote o ilia

> **Visi:** 26/12/2022 14:36
>
> Ngelen fuksat duke tregu vrimat.

Sali Berisha: 26/12/2022 12:42

Ky cerri I Shullazit,kujtonte se I kishte krahet e ngrohta,duke pastruar leket e bosave te droges dhe mendonte se ishte I paprekshem,e ka vertetuar koha qe cunat e Shqiperis se Mesme Jan me dobicat qe ekzistojn,asnjeri nuk I njeh kush jan, thjesht kur e mbush kupen te vrasin te hedhin ne det.

Përgjigju

> **Hot dogu:** 26/12/2022 20:40
>
> O salvatore hot dogu,nese ka njerez te pabes ne gjith historin e ketyre grupeve Jan keta "gangesterat dhe cunat me norma"se keta vriten me njeri-tjetrin kur te thash qe jan dobica per kte gje e kisha fjalen,pastaj ky I shkeli ne kallo Dukat,edhe e shef cfar e gjeti kte me shoket e ktij ,me pak fjal me Milin brenda ky ishte pa fuqi ,edhe billiona te kesh te cpon Talo Pe Qinit

> **Salvatore (Toto):** 26/12/2022 19:18

Pse Mili nga eshte o kollodok? Apo e dini Krujen e Fushe Krujen ne Kukes e jo Shqiperi e mesme? Me siguri duhet te jesh korcar me kto mendime. Varet per ke flet ne Shqiperi te mesme o djal, se ne Durres e Shijak kane nis prerjet ne bese sic jane bere disa here e Martinaj ishte i fundit.

Enver Hoxha: 26/12/2022 13:22

"Çunat" e tè mesmes, sè jugut apo tè veriut, bèjnè tè fortin, pèrsa kohè policia i lejon. Kur shteti, vèrtetè ka prioritet luftèn kundèr krimit,,,e shihni shpejt se si bèhet ÇUNI,,,GOCÈ,,,,edhe nga ato tè urtat fare biles.

Flamur Noka: 26/12/2022 13:02

Po.

Gjergj: 26/12/2022 11:42

Operacioni policor, flet mè shumè se 1000 fjalè. Zotèria, èshtè shèndoshè si molla siç duket dhe e ka menduar paksa ndryshe kètè punè, kur i hyri kèsaj rruge. Problemin, nuk e ka vetèm ai por edhe shumè tè tjerè nga politika, qè deri dje "ushqeheshin" me frutet e krimit tè zotèrisè. Njè shènim nè fund fare pèr tè gjithè ata qè mendojnè se Shqipèria èshtè vend cubash. Nè Shqipèri, bèhesh "cub" apo "i fortè", vetèm pèr aq kohè sa i nevojitesh politikès kriminale dhe ushtarève tè tyre me uniformè policie. Pa ta,,NUK KA ASNJI CUB SHQIPÈRIA SEPSE SHTETI JO VETÈM E ZÈ LEPURIN ME QERRE POR LEPURI KÈRCEN VETÈ ATY. Martinaj, èshtè LEPURI i radhès qè me shumè zhurmè e gjak, shkon si qeni nè rrush.!!!

Përgjigju

shoku: 26/12/2022 11:35

Mos u lodhni kot se po e hane peshqit ne te detit.

Përgjigju

Loku: 26/12/2022 15:50

Mos ofendo inteligjencèn dhe nuhatjen e peshqve, tè lutem.

Tano karidi dhe expinoza: 26/12/2022 11:35

Ai esht gjall Por desh me I bo gol indrit dokles qjoja (se eka vra indriti) qe indriti te futej në burg prap. Dhe ky te fitonte terrren prap qete organizohej ndaj kundershtarve.. Por nuk I heci pa fakte nuk te fut njeri në burg mo. Shikojeni se do jet me naj ferr në kurbin.

Përgjigju

Turi: 26/12/2022 11:13

Mbas renies se monizmit vetem shtet nuk kemi pasur ndonjehere kushdo ka qene ne pushtet por vitet e fundit politikanet e vendit jane kupola e krimit te organizuar ata qe jane ne pozite dhe ata qe jane ne opozite nuk ka asnje ndryshim . Populli u lodh , u frikesua deri ne palce nga vrasjet mafjoze qe organizojne puahtetaret dhe tani mbas kaq vitesh filloj ikjen masive si ne fillimin e viteve 90 . Nese ka ndonje politikan te ndershem i uroj gjithe te mirat kurse te tjereve me te keqijat e botes o funderina te ndyra o te pabese e fe , jeni bajga gomari qe nuk vleni per asgje

Përgjigju

Ethem Lalaj: 26/12/2022 10:48

Të gjëndet sezbën krimineli i gjall ose i vdekur.KRIMINELËT QË VRASIN NJËRZ DUHET TË VAREN TE SHESHI. Ata që mbrojnë hajdutët e vrasësit killer janë vet të tillë.Ky vënd nuk duhet të ket vënd për këta horra që po mbajnë PENG VËNDIN DHE PO ÇUDISIN BOTËN ME DROGË,PROSTITUCION,VJEDHJE,VRASJE..!

Përgjigju

Altini: 26/12/2022 10:13

E vrau shteti, tashi bejne show para mediave. Te gjithe njerezit e atij jane ne pergjim nga policia kriminale, operacionalja, shishi, jane ne survejim 24 ore ne 24...kjo me makina policie e blinda te renea eshte vetem per ti shqetesuar familjen dhe per te bere show.

Përgjigju

UKU MOMLIT: 26/12/2022 10:31

Altìn,mund te jete siç shkruan ti,por mund te jete edhe ndryshe,kot po themi: sikur te jete ne duart e sigurta te amerìkaneve....do jete a agjesuese per pafillon tone kryerilindas.

Hiku: 26/12/2022 10:19

Je shum i sakt.!!!!

Blenard: 26/12/2022 10:06

Po mir mo tani u kujtuat ta beni mbasi edhe e ka disifektuar edhe gishtrinjet e minjeve per mos len gjurme

Përgjigju

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH com

Sondazhi i ditës:
A besoni se policia do arrijë të zbardhë fatin e Ervis Martinajt?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Kërkimet në 'kështjellën' e Ervis Martinaj, Softa: Bosi i lojërave të fatit është gjallë! Të hetohen lidhjet e tij me politikën dhe bizneset, fshihen interesa të mëdha

26 Dhjetor, 17:41

FNSH 'zbarkon' në Elbasan, kontrolle për personazhe të njohura të krimit

25 Dhjetor, 20:32



Vendi në atmosferë festash, policia 'blindon' Vlorën (VIDEO)

24 Dhjetor, 21:52

Jo nga oxhaku! Në Lezhë, Babagjyshi shëtit qytetin me slitë me kalë, shpërndan dhurata për fëmijët: U gëzuan shumë (VIDEO)

24 Dhjetor, 16:36

Tregu bosh në Lezhë për festat e fundvitit, blerësit: Të ardhurat janë të pakta! Ekonomia është përtokë

24 Dhjetor, 16:26

Arrestohen 2 persona në Lezhë, u kapën me drogë, armë dhe municion luftarak në makinë! Nën hetim 20-vjeçari që nuk kallëzoi shokët

24 Dhjetor, 12:45

Dhunuan drejtorin e OSHEE-së në Lezhë, gjykata i lë në burg pa afat 2 autorët! Përndreca: Goditja për shkak të detyrës! Nuk tërhiqem nga puna

24 Dhjetor, 11:01

Erozioni/ Mbillen 800 fidanë në Lezhë, përgjegjësi i pyjeve: Të frenojmë vërshimin e përrenjve në zonat e banuara

Elvis Hila

23 Dhjetor, 17:34

U shiste kokainë të miturve në gjimnaze, pranga 54-vjeçares në Mamurras (EMRI)

23 Dhjetor, 10:58

Në gjurmët e "Djemve të Detit", rikthehet 'Rock-u' në Lezhë

Elvis Hila

22 Dhjetor, 15:53

EMRAT/ Morën porosi për të dhunuar drejtorin e OSHEE në Lezhë, arrestohen 2 të rinj! Akuzohen për goditje për shkak të detyrës

21 Dhjetor, 17:08

Njihuni me 39-vjeçarin nga Zadrima që mbarështon 40 mijë shpendë në vit: Në fillim më shihnin me përbuzje! Synoj të hap një kompleks

Elvis Hila

21 Dhjetor, 15:40

© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje